



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike (QSAB), në Fakultetin e Shkencave Humane, (FSHH) shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel akademik me kohë të plotë, të kategorisë lektor:

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatit të kategorisë lektor janë si më poshtë:

I.1. Kriteret e përgjithshme të kategorisë lektor

1. Kandidati duhet të ketë gradën shkencore Doktor (lektor) në fushën e arkeologjisë; (Grada e lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë e njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
2. Kandidati të ketë përfunduar studimet universitare (Bachelor dhe Master i Shkencave) dhe/ose ekuivalente me të, në fushën e Historisë/Arkeologjisë. (Diplomat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
3. Kandidati të zotërojë të paktën një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian;
4. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore të largimit nga puna;
5. Kandidati të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

I. 2. Kriteret e veçanta për kandidatin e kategorisë lektor janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të ketë kryer trajnime brenda dhe jashtë vendit në fushën kërkimore të arkeologjisë dhe trashëgimisë urbane restauruese;
2. Të ketë përvojë në hartim, menaxhim dhe zbatim projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arkeologjisë;
3. Të ketë përvojë në Ekspertiza/ Raporte kombëtare dhe ndërkombëtare në Arkeologji;
4. Të ketë pjesëmarrje në konferenca/simpoziume brenda fushës së arkeologjisë;
5. Të ketë botime brenda dhe jashtë vendit me fokus arkeologjinë, të cilat të jenë të dëshmuara dhe provuara.

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë zyrës së protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: www.uniel.edu.al).
2. Jetëshkrimi (CV).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.
5. Kopje e librezës së punës/vërtetim punësimi nga punëdhënësi për ekperiencën e punës
6. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti).
8. Raport i aftësisë për punë.
9. Fotokopje e letërnjoftimit.
10. Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (28.09.2026 – 07.10.2026) nga data e shpalljes në www.uniel.edu.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *personel akademik*,
QSAB
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit Shkencave Humane. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtohen intervistës me gojë (12.10.2026 – 30.10.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.